



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Shkodër më 12/01/2022

Formulari nr.3

FTESA PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Këshilli i Qarkut Shkodër
Adresa Rr.28 Nëntori, Shkodër
E-mail kozetavuksanlekaj@qarkushkoder.gov.al
Adresa e Internetit www.qarkushkoder.gov.al

Autoriteti Kontraktor Këshilli i Qarkut Shkodër do të zhvillojë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt “Shërbim për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit kompjuterik, serverit, faqes së internetit dhe shërbime të tjera IT (Shërbime IT)”, për Këshillin e Qarkut Shkodër.

Data e zhvillimit do të jetë **14 / 01 / 2022, ora 12:30**, në adresën www.app.gov.al.

Burimi i Financimit: Fondi për shpalljen e procedurave të prokurimit për vitin 2022 për prokurimin me objekt “Shërbim për mirëmbajtjen e rrjetit, sistemit kompjuterik, serverit, faqes së internetit dhe shërbime të tjera IT (Shërbime IT)” bazohet në PBA në mbështetje të Vendimit e Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.16, datë 30.12.2020 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimar 2021-2023”, të ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në mbështetje të Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5544 Prot. datë 08.09.2020 “Rekomandim mbi shpalljen e procedurave të prokurimit”, i cili ka qëllim shmangien e kontratave shtesë në fillim të vitit.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi në bazë të specifikimeve teknike të mëposhtme:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Operatori Ekonomik që do rezultojë fitues nga procedura elektronike e prokurimit, duhet të angazhojë një specialist IT shumë korrekt që të realizojë shërbimin e kërkuar në mënyrë shumë cilësore dhe me përgjegjësi.

Detyrat e Specialistit të IT

- Të mirëmbajë rrjetin, sistemin kompjuterik, serverin, faqen e internetit dhe shërbime të tjera IT;
- Të mirëmbajë faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Shkodër.
- Të azhurnojë çdo ditë faqen e internetit me materialet e aktiviteteve të administratës të Këshillit të Qarkut Shkodër.
- Të instalojë programin dhe vendosjen e "sigurimit të cilësisë së soft~~ware~~-eve" të Këshillit të Qarkut Shkodër, sipas nevojës;
- Të përpunojë komponentët soft~~ware~~ dhe / ose konfigurimin e paketave soft~~ware~~ të përdorura;
- Të mbajë/ruajë infrastrukturën hard~~ware~~ plotësisht operacionale;
- Të minimizojë/ulë joproduktivitetin për shkak të keqfunksionimit apo gabimeve;
- Të kontrollojë dhe të ruajë kërkesat funksionale të sigurisë;
- Te sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm për përdorimin korrekt të kompjuterave të administratës të Këshillit të Qarkut Shkodër;

- Të merret me kërkesat e mirëmbajtjes në mënyrë efikase;
- Të lehtësoje komunikimin me përdoruesit për ato probleme që nuk kërkojnë ndërhyrjen e drejtpërdrejtë në sistem.

Për realizimin e detyrave të mësipërme specialist IT që do të angazhohet nga operatori ekonomik duhet:

- Të ketë njohuri në sistemet operative **windows**, Linux, Mac;
- Të ketë njohuri për menaxhimin e serverave në sisteme operative **windows**, linux;
- Të ketë njohuri në sistemet e sigurisë së brendshme, menaxhimin e nvr, rrjetit, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Të ketë njohuri për krijimin dhe menaxhimin e faqeve të internetit si dhe rrjeteve sociale.
- Të ketë njohuri për krijimin e serverit të brendshëm për ruajtjen e të dhënave për faqen e internetit.
- Të ketë njohuri në gjuhë programimi si: HTML; HTML5; FLASH; PHP; MYSQL; MYSQLI; ACTIONSCRIPT; C+; C++; JAVASCRIPT; JAVA; APPLE SCRIPT; GOOLE APPS SCRIPT; OBJECTIVE-C; **SWIFT**; VISUAL BASIC; VISUAL BASIC .NET; **WINDOWS POWER SHELL**.
- Të ketë njohuri në programe si: ADOBE PHOTOSHOP; DREAM**WEAVER**; COREL; ADOBE PREMIERE; XCODE.
- Të ketë njohuri në CMS si: DRUPAL; **WORDPRESS**; JOOMLA.
- Të jetë i disponueshëm edhe pas orarit zyrtar të punës për mirëmbajtjen e rrjetit dhe serverit, ne rast nevojë.

Detyra të tjera të Specialistit të IT

- Të hartojë me përgjegjësi specifikimet teknike të kompjuterave, pajisjeve kompjuterike, printerave, fotokopjeve, kur lind nevoja e Këshillit të Qarkut Shkodër për realizimin e procedurave elektronike për pajisje të tilla.
- Të hartojë me përgjegjësi procesverbalet e konstatimit të difekteve të kompjuterave, fotokopjeve apo printerave, kur lind nevoja e mirëmbajtjes apo

rregullimit të tyre.

- Të monitorojë cilësinë dhe përmbushjen e specifikimeve teknike të ofrimit të shërbimit të internetit dhe të pasqyrojë me shkrim konstatimet për ofrimin e shërbimit të internetit.
- Gjatë procedurave të prokurimit Specialisti i IT duhet të kontrollojë nëse pajisjet kompjuterike, bojrat e printerit etj. përmbushin specifikimet teknike e kërkuara.
- Detyra të tjera të lidhura me fushën IT sipas nevojave të Këshillit të Qarkut Shkodër.

Operatori ekonomik duhet të angazhojë për realizimin e shërbimeve sipas specifikimeve të përcaktuara më sipër, një specialist IT i cili duhet të angazhohet gjatë gjithë orarit zyrtar të institucionit të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe të jetë i pranishëm për çdo problem që mund të dalë në server, në rrjet, në funksionimin e kompjuterave dhe pajisjeve të tjera IT të KQSH.

Afati i lëvrimit të shërbimit **11 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e lidhjes së kontratës. Gjatë përlllogaritjes së shpenzimeve mujore duhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", si dhe detyrimet e tjera ligjore që parashikohen nga ligji. Për rrjedhojë, tek zëri i kostos që pasqyrohet pagesa e punonjësit të shërbimit IT, duhet të zbatohen detyrimet ligjore për pagesën e punonjësit gjatë gjithë orarit zyrtar (174 orë/muaj). Nëse nga analiza e kostos të ofertës, rezulton se operatori ekonomik nuk zbaton detyrimet ligjore për kufirin minimal të pagesës të punonjësit të tij (174 orë në muaj), si dhe nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga AK, do të skualifikohet nga Autoriteti Kontraktor.

Dokumentacioni i kërkuar/Kriteret e kualifikimit të operatorit ekonomik

- Një Deklaratë me shkrim, që ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.
- Operatori ekonomik duhet të dorëzojë CV- në e punonjësit që do të angazhojë për kryerjen e mirëmbajtjes së faqes së internetit si dhe kryerjen e shërbimeve të tjera IT, ku duhet të ketë eksperience pune në drejtim rrjeti, eksperiencia të ngjashme, jo më pak se dy vite.
- Dorëzimi i ofertës me vlerën totale, të shoqëruar me analizën e kostos për shpenzimet mujore.

Afati i dorëzimit të **dokumentacionit** do të jetë **1 ditë** zyrtare pune nga kryerja e vlerësimit përfundimtar të ofertave në sistemin elektronik apo nga publikimi i fituesit, ku në rast tërheqje do të vijohet me shpalljen e fituesit sipas renditjes. Edhe nëse dokumentacioni nuk dorëzohet brenda afatit dhe nuk përmbushen specifikimet e kerkuara teknike, do të shpallet fitues operatori ekonomik vijues në klasifikim të ofertave (sipas radhës).

Në rastet se gjatë zbatimit të kontratës specialisti i IT i angazhuar nga operatori ekonomik, nuk zbaton detyrimet dhe detyrat e ngarkuara në bazë të specifikimeve teknike si dhe kontratës, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë nga operatori ekonomik fitues zëvendësimin e tij me një punonjës tjetër të përgjegjshëm dhe të aftë profesionalisht. Operatori ekonomik duhet të zëvendësojë menjëherë specialistin IT, me një punonjës tjetër që përmbush në mënyrë korrekte detyrat e përcaktuara në kontratë. Në rast të kundërt Autoriteti Kontraktor do të zgjidhë kontratën.

Të drejtat dhe detyrimet e Operatorit Ekonomik Fitues dhe Këshillit të Qarkut Shkodër, do të përcaktohen me kontratë shërbimi.

Përmbushja e specifikimeve teknike do të kontrollohet nga Grupi i Punës për Monitorimin e kryerjes së shërbimit (që do të përcaktohet në përmbajtjen e kontratës), të cilët do të vërtetojnë me procesverbal përmbushjen e detyrimeve të kontraktorit, si dhe do të monitorojnë mënyrën e ekzekutimit të kontratës gjatë gjithë kohës.

Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, ofertuesi i renditur në vend të parë, duhet të njoftojë nëpërmjet sistemit elektronik (menysë së mesazheve) autoritetin kontraktor, brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë. Në njoftim duhet të jepen arsyet, që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të refuzojë ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël të zhvilluar nga Këshilli i Qarkut Shkodër gjatë këtij viti, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor konfirmon Operatorin Ekonomik Fitues pas kalimit të afatit të ankesave, i cili duhet të paraqitet pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për të lidhur kontratën.

